

Vendim nr. 333, datë 24.12.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 24.12.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 29 (B) 2025 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **BARJAM BOCI, ELVIS BOCI**, përfaqësuar nga avokate Klodiana Gjyzari, me prokurë të posaçme dhe akt përfaqësimi.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 33, datë 21.03.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda; nr. 99, datë 20.11.2018 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda; nr. 00-2025-374 (59), datë 27.02.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 17, 18, 25, 31, 32, pika 2, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 3, 6 dhe 17 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në vitin 2014 nga ana e forcave të Policisë së Shtetit dhe strukturave të tjera shtetërore përgjegjëse është organizuar një operacion në shkallë të gjerë në fshatin Lazarat të Bashkisë së Gjirokastrës, me qëllim asgjësimin e bimëve narkotike “*cannabis sativa*” të kultivuara në këtë fshat dhe në zonat përreth tij. Si rezultat i këtij operacioni është bërë e mundur që të asgjësohen një numër i madh bimësh narkotike të kultivuara dhe të gjetura në gjendje të thatë, në vende të ndryshme, operacion, i cili është shoqëruar edhe me arrestimin e disa personave dhe shpalljen në kërkim të disa të tjerëve që janë konsideruar përgjegjës për kryerjen e kësaj veprimtarie kriminale. Pas kësaj ndërhyrjeje nga punonjësit e policisë në fshatin Lazarat kanë qëndruar të stacionuar pothuajse në mënyrë të vazhdueshme forca policie, ku bënin pjesë edhe reparti i Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë (*FNSH*) edhe ato RENEA, me qëllim ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike, si dhe pengimin e kultivimit të bimëve narkotike në fshat dhe në zonat përreth tij.

2. Më datën 24.06.2015, rreth orës 02:30 forcat e FNSH-së, të cilat ndodheshin të vendosura në vendin e quajtur “*Kazinoja e Abaz Rabit*” dhe “*Kryqëzimi i Përroit të Kordhocës*” në fshatin Lazarat janë qëlluar me armë zjarri me drejtim nga qendra e fshatit, ndërkohë që vazhdonin shërbimin. Po kështu, në orën 04:44 edhe një grup tjetër i FNSH-së që ishte me shërbim në vendin e quajtur “*Furra e bukës*” Kordhocë ka njoftuar se nga qendra e fshatit Lazarat ka pasur të shtëna me armë zjarri. Nga ana e Policisë së Shtetit në bashkëpunim me forcat RENEA është hartuar plani i operacionit për kapjen e këtyre personave, ku për këtë qëllim forcat e policisë janë nisur në drejtim të fshatit Lazarat me dy mjete autoblanda, si dhe një mjet furgon Volkswagen, me targa MB 060 AA. Gjatë udhëtimit në drejtim të fshatit kur automjeti Volkswagen me targa MB 060 AA, me forca të policisë të repartit RENEA ndodhej në afërsi të vendit të quajtur “*Pularia*”, në drejtim të këtij automjeti është qëlluar me breshëri armësh, ku si pasojë është vrarë efektiv i policisë, shtetasi I.B., dhe janë plagosur dy efektivë të tjerë, shtetasit J.I. dhe P.H.

3. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda në datën 24.6.2015 ka regjistruar procedimin penal nr.176, për kryerjen e veprave penale “Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit”, të kryer në bashkëpunim, “Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit”, të kryer në bashkëpunim, të mbetur në tentativë 5 herë, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe i municionit”, vepra këto të parashikuara nga nenet 79/b- 25, 79/b_ 22 -25, (5 herë) 278, paragrafët 2 dhe 5, të Kodit Penal (*KP*). Organi i akuzës, pasi ka kryer veprimet hetimore, ka arritur në përfundimin se ekzistojnë prova të plota se, ndër të tjerë, edhe kërkuesit Barjam Boci dhe Elvis Boci kanë kryer veprat penale “Vrasja e punonjësve të

Policisë së Shtetit”, “Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit”, e mbetur në tentativë, në 5 raste, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe i municionit”, “Grupi i strukturuar kriminal”, “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, të parashikuara nga nenet 79/b, 79/b-22, në 5 raste, 278, paragrafët 2, 3 dhe 4, 333/a, paragrafi 1, 334, pika 2, të KP-së. Ndërkohë 6 të pandehur të tjerë janë akuzuar për veprat penale “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, me dhunë, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe i municionit”, “Grupi i strukturuar kriminal”, “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, të parashikuara nga nenet 236, paragrafi 2, 278, paragrafët 2, 3 dhe 4, 333/a, paragrafi 2, 334, pika 1, të KP-së. Në datën 24.06.2016 organi akuzës ka paraqitur kërkesë përpara Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda për gjykimin e kërkuesve dhe të të pandehurve të tjerë.

4. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr. 33, datë 21.03.2018, ka vendosur deklarinim fajtor të kërkuesit Barjam Boci (në mungesë) për kryerjen e veprave penale “Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit”, “Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit”, e mbetur në tentativë, të parashikuara nga nenet 79/b, 79/b-22, në 5 raste, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armeve luftarake dhe i municionit”, të parashikuara nga neni 278, paragrafët 1, 3 dhe 4, të lidhura këto vepra me nenin 334, paragrafi 1, të KP-së, si dhe “Grupi i strukturuar kriminal”, të parashikuar nga neni 333/a, paragrafi 2, i KP-së, duke e dënuar përfundimisht me burgim të përjetshëm. Po kështu, ajo gjykatë ka vendosur deklarinim fajtor edhe të kërkuesit Elvis Boci për kryerjen e të njëjtave vepra penale, duke e dënuar përfundimisht me 35 vjet burgim. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim kërkuesit.

5. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr. 99, datë 20.11.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 33, datë 21.03.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda për të dy kërkuesit. Për rekursin e kërkuesve Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2025-374 (59), datë 27.02.2025, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 99, datë 20.11.2018 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, për sa u takon kërkuesve.

6. Në datën 17.09.2025 kërkuesi Barjam Boci ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij. Po në të njëjtën datë ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatë edhe kërkuesi tjetër Elvis Boci. Në vijim, të dy kërkuesit bashkërisht kanë paraqitur sërish ankim kushtetues individual në datën 21.09.2025 (sipas shërbimit postar). Kolegji, pasi ka konstatuar se tre ankimet kishin të njëjtin objekt dhe, në thelb, bazoheshin po mbi të njëjtat shkaqe, në datën 07.11.2025 ka vendosur bashkimin e tyre në një kërkesë të vetme, objekt shqyrtimi.

II

Pretendimet e kërkuesve

7. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se u janë cenuar:

7.1. *E drejta për një proces të rregullt ligjor në drejtim të:*

7.1.1. *Së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi nga gjykatat e zakonshme nuk u arrit të provohej kryerja e veprës penale nga kërkuesit lidhur me anën objektive të saj. Për sa i takon anës subjektive, ku kërkohet dashja direkte, nga dëshmitë e punonjësve të policisë nuk ka rezultuar asgjë me interes për autorët, duke mos arritur t'i specifikojnë ata. Gjykata e shkallës së parë ka konkluduar se fajësia është vërtetuar mbi dëshmitë e tre personave, të cilët më pas i kanë ndryshuar ato dhe se në gjykim ka pasur vetëm indicie dhe dëshmi kontradiktore. Gjithashtu, ajo gjykatë nuk ka arritur të argumentojë edhe faktin se përse vrasja e punonjësve të policisë ka mbetur në tentativë, ndërkohë që qëllohej me breshëri në ajër dhe jo drejt makinave të policisë. Po kështu, fajësia e kërkuesve është mbështetur kryesisht në deklaratimet e të bashkëpandehurve pa u konfirmuar me prova të tjera në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penale (*KPP*).

Edhe gjykata e apelit, në të njëjtën linjë me gjykatën e shkallës së parë i ka përmendur dëshmitë dhe provat në mënyrë të përgjithshme, por pa analizuar se cilat prova konkrete mbështesnin dyshimet për fajësinë e kërkuesve.

Gjykata e Lartë ka vijuar të njëjtën qasje si gjykatat e faktit, duke mos u dhënë përgjigje pretendimeve kushtetuese të ngritura në rekurs, si, papërdorshmëria e provave të marra nën ushtrimin e dhunës, në kundërshtim me nenin 25 të Kushtetutës, si dhe duke konfunduar kompetencat e saj në shqyrtimin paraprak në dhomën e këshillimit me ato të seancës gjyqësore. Vendimi i Gjykatës së Lartë është plotësisht i paarsyetuar.

7.1.2. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi ata janë vënë në dajeni pas marrjes së vendimit nga Gjykata e Lartë se gjyqtarja I.Gj., pjesë e trupit gjykues në shkallë të parë, ka rezultuar e dënuar nga Gjykata e Shkallës së Parë Janinë për veprën penale “Falsifikimi i pasaportave dhe i vizave”, çka përbën shkak për humbjen e statusit të magjistratit. Ky fakt cenon vendimin e marrë nga gjykata e shkallës së parë, për rrjedhojë, bazuar dhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), shkel parimin e “gjykatës së caktuar me ligj”.

Lidhur me përbërjen e Kolegjit Penal në Gjykatën e Lartë, rezulton se dorëheqja e gjyqtarit S.S. nuk duhej të ishte pranuar, për shkak se nuk ishte e vërtetë se kishte shprehur mendim në një çështje në shkallë të parë. Çështja në fjalë kishte përfunduar

me vendim në datën 18.01.2016, ndërkohë që çështja objekt shqyrtimi nuk kishte ndodhur ende, nuk ishte procedim i lidhur dhe nuk kishte prova të përbashkëta. Për më tepër që në këtë çështje nuk ishte gjykuar i bashkëpandehuri A.A., si dhe nuk rezultonte që të ishte çështje e lidhur. Për sa u takon dorëheqjeve të gjyqtarëve M.B. dhe I.P., edhe këto janë pranuar në mënyrë të gabuar, pasi çështja e gjykuar prej tyre nuk kishte lidhje me të bashkëpandehurin A.A., por me një tjetër person, R.M. I bashkëpandehuri në këtë rast është gjykuar nga gjyqtari E.Dh., i cili është edhe gjyqtar në çështjen objekt gjykimi dhe që në rastin konkret duhej të kishte dhënë dorëheqjen. Si rezultat i këtyre dorëheqjeve rezulton se çështja është gjykuar nga gjyqtarët e Kolegjit Civil, të cilët nuk kishin kualifikimin e duhur për të gjykuar një çështje penale.

7.1.3. *Parimit të paanshmërisë*, pasi gjyqtarët e shkallës së parë duhet të kishin dhënë dorëheqjen referuar nenit 17, pika 1, shkronja “c” të KPP-së, pas revokimit të vendimit për të proceduar me gjykim të shkurtuar, për shkak se prokuroria u kishte vënë në dukje gjyqtarëve se, për sa u përket kërkesave të kërkuësve për pavlefshmërinë e deklarimeve të E.K. dhe K.S., ishte shprehur në momentin kur kishte pranuar kërkesën për gjykim të shkurtuar, se këto akte ishin të vlefshme. Në përbërje të trupit gjykues në shkallën e parë ka qenë gjyqtarja I.Gj., e cila ka shprehur opinion lidhur me faktin se edhe kërkuesi Elvis Boci duhej të dënohej me burgim të përjetshëm.

7.1.4. *Së drejtës për t’u mbrojtur dhe parimit të barazisë së armëve*, pasi atyre u është kufizuar e drejta për riçelje të procesit gjyqësor në gjykatën e apelit dhe marrja e provave të tjera, të cilat nuk ishin kërkuar në gjykimin në shkallë të parë, por që cilësoheshin të nevojshme në vijim të shqyrtimit të çështjes. Ky fakt i ka vendosur ata në pozita të pabarabarta dhe gjykata e apelit nuk ka dhënë argumente për refuzimin, përveç faktit që këto prova nuk ishin kërkuar të merreshin në ankimin e bërë në gjykatën e apelit, duke treguar formalizëm të tepruar. Po kështu, gjykatat në dhënien e vendimit të tyre kanë përzgjedhur vetëm deklaratat e kërkuara nga prokuroria dhe vetëm ato pjesë të cituara prej tyre.

Një shkelje tjetër e së drejtës së mbrojtjes ka të bëjë edhe me faktin se për kërkesën e tyre për revokim të gjykimit të shkurtuar janë gjykuar me gjykim të zakonshëm edhe të bashkëpandehurit e tjerë.

Po kështu, një tjetër element i cenimit të së drejtës së mbrojtjes është edhe fakti se në disa seanca, një pjesë e të pandehurve të tjerë janë gjykuar në mungesë të avokatëve. Ndërkohë ka rezultuar gjithashtu se disa procesverbale seancash

gryqësore nuk janë të nënshkruara nga kryetari i trupit gjykues në kundërshtim me nenin 115 të KPP-së, çka i bën ato të pavlefshme.

7.2. *Parimi i prezumimit të pafajësisë*, pasi në gjykimin në shkallë të parë trupi gjykues është shprehur për fajësinë e të pandehurve, duke pohuar se do të jepej vendim fajësie. Po kështu, ky fakt përforcohet edhe me kohën e shkurtër të bisedimeve në dhomën e këshillimit përpara shpalljes së vendimit.

Gjykatat i kanë vlerësuar provat në mënyrë të njëanshme, duke marrë në konsideratë dhe duke i dënuar ata mbi prova të marra nën ushtrimin e dhunës dhe, për rrjedhojë, të papërdorshme. Mënyra sesi gjykatat i kanë analizuar provat, ka rezultuar me zhvendosje të barrës së provës nga prokurori te kërkuesit.

Një tjetër fakt që fikon shkeljen e parimit të prezumimit të pafajësisë është edhe mënyra sesi prokuroria i ka mbiquajtur të pandehurit, duke iu referuar atyre si “grupi i zjarrit”, term ky që është referuar edhe nga gjykata e apelit.

Nga ana e organit procedues fillimisht është nxjerrë në kërkim shtetasi E.B., babai i kërkuesve, dhe vetëm pasi është marrë dijeni se ai ishte në burg, për të justifikuar veprimet e tyre, është shoqëruar kërkuesi Elvis Boci dhe është nxjerrë në kërkim i vëllai, kërkuesi tjetër Barjam Boci.

7.3. *E drejta për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, e garantuar nga neni 32, pika 2, i Kushtetutës*, pasi të gjykuarit e mitur A.A., E.K., Xh.M. dhe O.P., me hyrjen në fuqi të ndryshimeve të KPP-së dhe të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, janë gjykuar në disa seanca pa praninë e psikologut. Nga ana e gjykatave janë pranuar deklaratimet e E.K., Xh.M. dhe K.S., si dhe të vet kërkuesit Elvis Boci të marra nën ushtrimin e dhunës dhe të torturës nga Policia e Shtetit dhe organi procedues, në kundërshtim edhe me nenin 25 të Kushtetutës, çka i bën këto prova të papërdorshme. Gjykatat nuk i kanë verifikuar këto pretendime, të cilat kanë qenë serioze, të besueshme dhe të mundshme për verifikim.

Në rastin e dëshmisë së K.S., njohja me fotografi e kërkuesve është bërë në kundërshtim me procedurën e kërkuar nga nenet 171 e vijues të KPP-së, duke e bërë këtë njohje të paligjshme.

Gjatë marrjes në pyetje të të miturve Xh.M. dhe E.K., dëshmitë e të cilëve kanë ndikuar në dënimin e kërkuesve, në kushtet kur ata ishin të mitur, nuk janë njoftuar prindërit, referuar nenit 255, pika 4, të KPP-së, si dhe në rastin e deklaratimit Xh.M. ai nuk është përfaqësuar në marrjen në pyetje nga avokati i zgjedhur nga familja, por nga avokat i caktuar kryesisht.

7.4. *Parimi i gjykimit të drejtë*, pasi kërkuesi Barjam Boci nuk është njoftuar për ndryshimin e procedurës së gjykimit, ndërkohë që kishin ndryshuar dispozitat procedurale për gjykimin në mungesë dhe gjykata e shkallës së parë duhej të pezullonte gjykimin për këtë kërkues për 1 vit. Gjithashtu, ai është lejuar që të mbrohet nga i njëjti mbrojtës që përfaqësonte një të bashkakuzuar tjetër, me të cilin rrethanat procedurale dëshmuuan papajtueshmëri.

7.5. *Parimi i sigurisë juridike dhe parimi i barazisë përpara ligjit*, pasi në kushtet kur Gjykata e Lartë ka praktikë të konsoliduar për pavlefshmërinë absolute të vendimeve gjyqësore dhe faktin që ajo mund të konstatohet kryesisht në çdo fazë të procesit, edhe kur pala nuk mund ta kërkojë atë, Kolegji Penal në këtë rast ka vepruar ndryshe.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesve

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Lidhur me legjitimitimin *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Kjo do të thotë se individi mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij, si dhe të provojë se në çfarë mënyre është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Kërkuesit, në kuadër të pretendimit të cenimit të së drejtës për të mos u deklaruar fajtorë mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, kanë dhënë si argument, ndër të tjera, edhe faktin se të gjykuarit e mitur A.A., E.K., Xh.M. dhe O.P., me hyrjen në fuqi

të ndryshimeve të KPP-së dhe Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, janë gjykuar në disa seanca pa praninë e psikologut.

11. Gjithashtu, kërkuesit, në kuadër të pretendimit për cenimin e *së drejtës për t'u mbrojtur*, kanë dhënë si argumente faktin se për kërkesën e tyre për revokimin e gjykimit të shkurtuar u gjykuan me gjykim të zakonshëm edhe të bashkëpandehurit e tjerë. Po kështu, sipas kërkuesve, një tjetër element i cenimit të së drejtës së mbrojtjes është edhe fakti se në disa seanca disa nga të pandehurit e tjerë janë gjykuar në mungesë të avokatëve.

12. Kolegji vëren se kërkuesit për këto pretendime, në lidhje me argumentet e dhëna, nuk provojnë interesin e tyre të drejtpërdrejtë, pasi kanë pretenduar cenimin e të drejtave kushtetuese të personave të tjerë dhe nuk kanë provuar të drejtën e cenuar ose interesin e tyre të ligjshëm vetjak në këtë drejtim, për pasojë ata nuk legjitimohen *ratione personae*. Ndërsa për sa u përket pretendimeve të tjera të paraqitura në ankimin kushtetues individual, Kolegji konstaton se ato lidhen me procesin gjyqësor ku kërkuesit kanë qenë palë dhe kanë interesa të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi, për rrjedhojë ata legjitimohen *ratione personae*.

13. Një tjetër kriter paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Në të njëjtën linjë neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i Ligjit Organik të Gjykatës, përcakton se mjetet juridike efektive duhet të shterohen nga kërkuesi përpara se ai t’i drejtohet Gjykatës.

14. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili përpara se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Kërkuesit, në kuadër të pretendimit për cenimin e *parimit të gjykimit të drejtë*, kanë dhënë si argumente faktin se kërkuesi Barjam Boci nuk ishte njoftuar për ndryshimin e procedurës së gjykimit, ndërkohë që kishin ndryshuar edhe dispozitat procedurale për gjykimin në mungesë dhe gjykata e shkallës së parë duhej të pezullonte gjykimin për këtë kërkues për 1 vit. Gjithashtu, ai është lejuar që të mbrohet nga i njëjti mbrojtës që përfaqësonte një të bashkakuzuar tjetër, me të cilin rrethanat procedurale dëshmuuan papajtueshmëri.

16. Po kështu, në kuadër të *së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme*, kërkuesit kanë pretenduar se gjatë marrjes në pyetje të miturve Xh.M. dhe E.K., dëshmitë e të cilëve kanë ndikuar në dënimin e kërkuesve, në kushtet kur ata ishin të mitur, nuk janë njoftuar prindërit referuar nenit 255, pika 4, të KPP-së, si dhe në rastin e deklaruesit Xh.M. ai nuk është përfaqësuar në marrjen në pyetje nga avokati i zgjedhur nga familja, por nga avokat i caktuar kryesisht.

17. Për sa u takon këtyre argumenteve, Kolegji konstaton se ato nuk janë ngritur as në ankim dhe as në rekurs nga ana e kërkuesve, duke mos shteruar në këtë mënyrë të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese. Në këtë kontekst, Kolegji çmon se këto argumente nuk mund të merren në shqyrtim.

18. Për sa u takon pretendimeve të tjera të tyre, Kolegji vëren se kërkuesit i kanë ngritur ato në të tria shkallët e sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe pasi kanë shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta, duke mos pasur mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese. Po kështu, Kolegji evidenton se edhe për pretendimet që kanë të bëjnë me procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, kërkuesit nuk kanë mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual. Prandaj Kolegji vlerëson se kërkuesit e kanë përmbushur këtë kriter.

19. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në çështjen konkrete, Kolegji evidenton se vendimi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesit, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 27.02.2025, kurse kërkesat janë paraqitur në Gjykatë respektivisht në datën 17.09.2025. Nga ana e kërkuesve, bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, është paraqitur *e-mail*-i i dërguar nga Gjykata e Lartë që u ka komunikuar vendimin e saj në datën 19.05.2025, pra rezulton se kërkesat janë paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, për pasojë ata legjitimohen *ratione temporis*.

21. Për sa i takon legjitimitit *ratione materiae*, Kolegji konstaton se kërkuesit kanë pretenduar cenimin e *së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit*

gjqësor, së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimit të paanshmërisë, së drejtës për t'u mbrojtur, prezumimit të pafajësisë dhe së drejtës për të mos u deklaruar fajtorë mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme.

22. Kërkuesit kanë pretenduar cenimin e *parimit të paanshmërisë*, pasi gjyqtarët e shkallës së parë duhet të kishin dhënë dorëheqjen referuar nenit 17, pika 1, shkronja “c” të KPP-së, pas revokimit të vendimit për të proceduar me gjykim të shkurtuar, për shkak se prokuroria iu kishte vënë në dukje gjyqtarëve se, për sa u përket kërkesave të kërkuesve për pavlefshmërinë e deklarimeve të E.K. dhe K.S., ishte shprehur në momentin kur kishte pranuar kërkesën për gjykim të shkurtuar se këto akte ishin të vlefshme. Një tjetër argument është edhe fakti se në përbërje të trupit gjykues në shkallën e parë ka qenë gjyqtarja I.Gj., e cila ka shprehur opinion për faktin se edhe kërkuesi Elvis Boci duhej të dënohej me burgim të përjetshëm.

23. Në nenin 42 të Kushtetutës parashikohet, ndër të tjera, se të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e tyre, ka të drejtën e një gjykimi nga një gjykatë e paanshme. E drejta për një gjykatë të paanshme nënkupton mungesën e paragjykimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njëres prej palëve. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo gjithashtu duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 38, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Gjithashtu, respektimi i parimit të paanshmërisë duhet të verifikohet, duke aplikuar testin subjektiv, që ka të bëjë me verifikimin e bindjes ose të interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar, si dhe testin objektiv, me të cilin shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 23, datë 04.11.2008; nr. 11, datë 02.04.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Veçanërisht për sa i përket kriterit të dytë, nëse ky kriter zbatohet për anëtarët e trupit gjykues, ai nënkupton se përveç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues duhet të provohet nëse ka fakte bindëse të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër, edhe dukja e jashtme mund të ketë njëfarë rëndësie. Në përcaktimin nëse një çështje konkrete ka arsye logjike për të dyshuar se një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që ankohen për diçka të tillë është i rëndësishëm, por jo vendimtar. Në fakt, vendimtare është nëse objektiviteti i këtyre dyshimeve është mjaftueshëm i bazuar (*shih vendimin nr. 49, datë 16.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në rastin konkret, nisur nga natyra e pretendimeve të kërkuesve, Kolegji evidenton se ato ngrihen si në aspektin *objektiv*, ashtu dhe në atë *subjektiv*. Konkretisht, për pretendimin

për mungesë paanshmërie nga gjyqtarja I.Gj. nuk rezulton që kërkuesit të kenë paraqitur ndonjë provë konkrete që të vërtetojë se nga ana e saj janë dhënë opinionet e pretenduara. Ndërkohë, për pretendimin tjetër të tyre, faktet e paraqitura, lidhur me deklaratat e prokurorëve të çështjes nuk vënë në dyshim paanshmërinë e gjykatës, për sa kohë që bëhet fjalë për ushtrimin e kompetencave të tyre procedurale brenda procesit penal. Ky pohim i gjykatës lidhet me faktin se nga vetë kërkuesit fillimisht është pranuar gjykimi i shkurtuar, çka presupozon pranimin e provave në gjendjen që janë dhe në momentin që ka pasur pretendime për vlefshmërinë e provave, gjyqtarët për kërkesën e mbrojtjes kanë ndryshuar formën e gjykimit, duke shqyrtuar pretendimet për pavlefshmëri të akteve dhe duke mbajtur qëndrim për to. Ky moment procedural është konsideruar konform ligjit edhe nga gjykata e apelit dhe, më tej, nga Gjykata e Lartë. Për sa më sipër, në kushtet kur ajo gjykatë ka pranuar gjykimin e zakonshëm pikërisht për të shqyrtuar ligjshmërinë e marrjes së provave, pretendimet e kërkuesve për njëanshmëri janë haptazi të pabazuara.

26. Kërkuesit gjithashtu kanë pretenduar edhe cenimin e *së drejtës për t'u mbrojtur edhe parimin e barazisë së armëve*, pasi iu është kufizuar e drejta për riçelje të procesit gjyqësor në gjykatën e apelit dhe marrja e provave të tjera, të cilat nuk ishin kërkuar në gjykimin në shkallë të parë, por që cilësoheshin të nevojshme në vijim të shqyrtimit të çështjes. Ky fakt i ka vendosur ata në pozita të pabarabarta dhe gjykata e apelit nuk ka dhënë argumente për refuzimin, përveç faktit që këto prova nuk ishin kërkuar të merreshin në ankimin e bërë në apel, duke treguar formalizëm të tepruar. Po kështu, gjykatat, në dhënien e vendimit të tyre, kanë përzgjedhur vetëm deklaratat e kërkuara nga prokuroria dhe vetëm ato pjesë të cituara prej tyre, duke cenuar parimin e barazisë së armëve. Gjithashtu, kërkuesit kanë argumentuar se disa procesverbale seancash gjyqësore nuk janë të nënshkruara nga kryetari i trupit gjykues në kundërshtim me nenin 115 të KPP-së, çka i bën ato të pavlefshme.

27. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pranuar se e drejta e mbrojtjes në procesin penal ka përmbajtje substanciale, ajo duhet të jetë reale dhe efektive e jo vetëm teorike dhe se ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por, përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të rregullt ligjor t'i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve (*shih vendimet nr. 34, datë 17.11.2022; nr. 35, datë 01.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Lidhur me parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, Gjykata ka theksuar se ai është i lidhur ngushtë me të drejtën e personit të akuzuar për t'u mbrojtur në një gjykim të drejtë (*shih vendimet nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 12, datë 24.04.2018; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*),

28. Lidhur me këtë pretendim, Kolegji vëren se nga ana e kërkuësve në shkallë të parë është kërkuar vijimi i gjykimit me procedurë të zakonshme. Në atë gjykim kërkuësit kanë pasur mundësinë të debatojnë për provat dhe të kërkojnë marrje të provave të tjera (përveç atyre të prokurorisë), si dhe thirrjen e dëshmitarëve. Nga aktet bashkëlidhur ankimit kushtetues individual kushtetues, si dhe nga vendimi i gjykatës së apelit (*shih faqen 29 të vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda*), nuk rezulton që nga ana e kërkuësve të jetë kërkuar marrja e provave të pretenduara gjatë gjykimit në shkallë të parë. Këto prova në vijim nuk janë pretenduar as në ankimin e paraqitur nga kërkuësit dhe as në plotësimin e tij.

29. Duke mbajtur parasysh për sa më sipër, Kolegji vlerëson këto pretendime për marrje provash nga kërkuësit nuk janë ngritur as në shkallë të parë dhe as në ankimet e paraqitura nga kërkuësit për vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Për më tepër, gjykata e apelit, në zbatim të nenit 427, pikat 1, 2 dhe 3, të KPP-së, nuk detyrohet që të përsërisë shqyrtimin gjyqësor në çdo rast dhe kjo është një çështje që ngelet në diskrecionin e saj. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se ky argument i kërkuësve është haptazi i pabazuar.

30. Në lidhje me pretendimin se gjykatat në dhënien e vendimeve të tyre kanë përzgjedhur vetëm deklaratat e kërkuara nga prokuroria dhe vetëm ato pjesë të cituara prej tyre, duke cenuar parimin e barazisë së armëve, Kolegji evidenton se shqyrtimi i çështjes në shkallë të parë është bërë me gjykim të zakonshëm dhe në kushtet kur mbrojtja nuk ka arritur të provojë të kundërtën, megjithëse i ka pasur mundësitë për shkak të llojit të gjykimit, gjykatat kanë referuar ato prova, të cilat i kanë vlerësuar si të rëndësishme në përcaktimin e fajësisë së kërkuësve. Në këtë kontekst, Kolegji çmon se edhe ky argument i kërkuësve është haptazi i pabazuar.

31. Për sa i përket pretendimit tjetër të kërkuësve, që lidhet me mosfirmosjen e procesverbaleve të seancave nga kryetari i trupit gjykues, gjykata ka theksuar se procesi i gjykimit kushtetues është i natyrës argumentuese, që nënkupton se u takon palëve të parashtrajnë argumentet faktike dhe ligjore mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre (*shih vendimet nr. 57, datë 25.07.2017; nr. 42, datë 25.05.2017; nr. 45, datë 29.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë optikë, Kolegji vëren se nuk rezulton që kërkuësit të kenë argumentuar se në çfarë mënyre i janë cenuar të drejtat e tyre kushtetuese nga ky fakt. Për rrjedhojë, edhe ky argument rezulton haptazi i pabazuar.

32. Një kërkim tjetër i kërkuësve ka të bëjë me cenimin e *parimit të gjykatës së caktuar me ligj*, kjo pasi, *së pari*, ata pas dhënies së vendimit nga Gjykata e Lartë janë vënë në dijeni se gjyqtarja I.Gj., pjesë e trupit gjykues në shkallë të parë, ka rezultuar e dënuar nga Gjykata e Shkallës së Parë Janinë për veprën penale “Falsifikimi i pasaportave dhe i vizave”, çka përbën shkak për humbjen e statusit të magjistratit. Ky fakt cenon vendimin e marrë nga gjykata e

shkallës së parë dhe, për rrjedhojë, bazuar edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së, shkel parimin e “gjykatës së caktuar me ligj”.

33. *Së dyti*, lidhur me përbërjen e Kolegjit Penal në Gjykatën e Lartë, rezulton se dorëheqja e gjyqtarit S.S., nuk duhej të ishte pranuar, për shkak se nuk ishte e vërtetë që kishte shprehur mendim në një çështje në shkallë të parë. Çështja në fjalë kishte përfunduar me vendim në datën 18.01.2016, ndërkohë që çështja objekt shqyrtimi nuk kishte ndodhur ende, nuk ishte procedim i lidhur dhe nuk kishte prova të përbashkëta. Për më tepër që në këtë çështje nuk ishte gjykuar i bashkëpandehuri A.A., si dhe nuk rezultonte që të ishte çështje e lidhur. Për sa u përket dorëheqjeve të gjyqtarëve M.B. dhe I.P., edhe këto janë pranuar në mënyrë të gabuar, pasi çështja e gjykuar prej tyre nuk kishte lidhje me të bashkëpandehurin A.A., por me një tjetër person, R.M. I bashkëpandehuri në këtë rast është gjykuar nga gjyqtari E.Dh., i cili është edhe gjyqtar në çështjen objekt gjykimi dhe që në rastin konkret duhej të kishte dhënë dorëheqjen. Si rezultat i këtyre dorëheqjeve rezulton se çështja është gjykuar nga gjyqtarët e Kolegjit Civil, të cilët nuk kishin kualifikimin e duhur për të gjykuar një çështje penale.

34. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se një nga elementet e procesit të rregullt, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një “gjykatë e caktuar me ligj”. Ky element, në sensin material, karakterizohet nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar për një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik (*shih vendimet nr. 36, datë 30.04.2024; nr. 3, datë 07.02.2023; nr. 7, datë 23.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Lidhur më argumentin e parë, për gjykimin e çështjes nga një gjyqtare e cila nuk plotëson kushtet për të qenë e tillë, Kolegji evidenton se neni 66 “*Pazgjedhshmëria dhe papajtueshmëria*” i ligjit nr. 96/2017 “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*” përcakton se statusi i magjistratit përfundon kur autoriteti kompetent përcakton me vendim shkaqet e papajtueshmërisë. Në rastin konkret, referuar legjislacionit të fushës, organi kompetent rezulton të jetë Këshilli i Lartë Gjyqësor. Mbi këtë fakt, Kolegji çmon se, për sa kohë nuk ka ndonjë akt të organit publik të ngarkuar nga ligji që të ketë vendosur për ndalimin e ushtrimit të funksionit nga ajo gjyqtare për shkakun e pretenduar nga kërkuesit ose për ndonjë shkak tjetër ligjor, gjyqtarja në fjalë, ndërsa ka qenë në detyrë, ka vepruar në kushte legjitimiteti në ushtrimin e funksioneve dhe, për pasojë, pretendimi i tyre është qartazi pa bazë ligjore.

36. Lidhur me argumentin tjetër të tyre, në kontekst të cenimit të së drejtës për gjykim nga një gjykatë e caktuar me ligj, në thelb, kërkuesit pretendojnë që, si pasojë pranimit të

dorëheqjeve jo në përputhje me kriteret e KPP-së, çështja e tyre është gjykuar nga gjyqtarë jokompetentë, të cilët i përkisnin juridiksionit civil.

37. Për sa i takon këtij pretendimi, nga aktet e nxjerra nga dosja gjyqësore e Gjykatës së Lartë, e vënë në dispozicion nga kërkuesit, rezulton që të pestë gjyqtarët që përbëjnë Kolegjin Penal kanë paraqitur dorëheqje për shkaqe të cilat janë vlerësuar nga ata, e më pas konfirmuar nga kryetari i Gjykatës së Lartë, që do të cenonin paanshmërinë e tyre në gjykimin e çështjes së kërkuesve, për shkak të çështjeve të lidhura dhe të bashkëpandehurve të tjerë (në çështjen objekt shqyrtimi), të cilët ishin gjithashtu të pandehur në dosje të shqyrtuara më parë nga anëtarët e atij kolegji. Ndodhur në situatën kur Gjykata e Lartë nuk ka pasur më në dispozicion gjyqtarë të Kolegjit Penal, për të siguruar mbarëvajtjen dhe gjykimin e çështjes së kërkuesve, gjykimi është kryer nga anëtarët e trupit gjykues të Kolegjit Civil të asaj gjykate. Në këtë aspekt, nuk rezulton që ky fakt të ketë cenuar të drejtat kushtetuese të kërkuesve, për rrjedhojë vlerësohet si haptazi i pabazuar.

38. Nga ana e kërkuesve është pretenduar edhe cenimi i *parimit të prezumimit të pafajësisë*, në disa drejtime. *Së pari*, kërkuesit kanë argumentuar se në gjykimin në shkallë të parë trupi gjykues është shprehur për fajësinë e të pandehurve, duke pohuar se do të jepej vendim fajësie. Po kështu, ky fakt përforcohet edhe me kohën e shkurtër të bisedimeve në dhomën e këshillimit përpara shpalljes së vendimit. *Së dyti*, kërkuesit kanë dhënë si argument për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë mënyrën sesi prokuroria i ka mbiquajtur të pandehurit, duke iu referuar atyre si “grupi i zjarrit”, term ky që është referuar edhe nga gjykata e apelit. *Së treti*, kërkuesit kanë ngritur si argument edhe faktin se nga ana e organit procedues fillimisht është nxjerrë në kërkim shtetasi E.B., babai i kërkuesve dhe vetëm pasi është marrë dijeni se ai ishte në burg, për të justifikuar veprimet është shoqëruar kërkuesi Elvis Boci dhe është nxjerrë në kërkim i vëllai, kërkuesi tjetër Barjam Boci.

39. Gjykata ka theksuar se, në rastin e gjykimin penal, parimi i prezumimit të pafajësisë është një nga elementet përbërëse të procesit të rregullt ligjor. Ai kërkon që deklarimi i fajësisë të të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes. Asnjë masë që barazohet me dënimin nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 27, datë 29.04.2025; nr. 20, datë 03.04.2024; nr. 4, datë 21.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet. Barra e provës i takon palës akuzuese dhe çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit. Gjykatat duhet ta mbështesin vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza. Ato janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur, dhe

nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime ose dyshime (*shih vendimet nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 10, datë 12.04.2022; nr. 12, datë 24.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Në lidhje me argumentin e parë, kërkuesit nuk kanë paraqitur prova që të provojnë pretendimin e tyre, por janë mjaftuar vetëm duke e përmendur këtë pretendim. Për më tepër, nga aktet bashkëlidhur nuk rezulton që kërkuesit të kenë paraqitur kërkesë për përjashtimin eventual të gjyqtarit ose të gjyqtarëve. Ndërkohë që për kohën e vendimmarrjes nga ana e trupit gjykues në shkallë të parë, Kolegji vëren se në kontekstin e rrethanave konkrete të çështjes, kohëzgjatja e bisedimeve të trupit gjykues në dhomën e këshillimit nuk përbën në vetvete argument të mjaftueshëm kushtetues. Gjykimi i çështjes ka vijuar në kohë për më shumë se një vit dhe anëtarët e trupit gjykues kanë pasur mundësi të dëgjojnë drejtpërdrejt dhe të reflektojnë për çdo pretendim të palëve, sikundër edhe për provat e marra në gjykim dhe të dhënat e ofruara nga ato. Për këtë arsye, fakti që vendimi i gjykatës së shkallës së parë në rigjykimin e çështjes është shpallur i arsyetuar në një kohë të shkurtër, nga tërheqja për vendim, nuk përbën argument të mjaftueshëm për të vërtetuar shkeljen e parimit të prezumimit të pafajësisë, ndaj pretendimi i kërkuesve bazuar në këtë argument nuk qëndron.

41. Për këtë argument, Kolegji vlerëson që vetëm mënyra sesi i ka identifikuar kërkuesit dhe të bashkëpandehurit e tjerë prokuroria ose edhe gjykata e apelit nuk përbën *per se* argument të mjaftueshëm për cenimin e të drejtave të tyre kushtetuese.

42. Për argumentin e tretë, Kolegji çmon se ky pretendim i kërkuesve lidhet me veprimet e para hetimore të kryera nga Policia e Shtetit për informacionet operative që ajo strukturë disponon, ndërkohë që hetimi i mëtejshëm ka vijuar me shoqërimin dhe nxjerrjen në kërkim të autorëve të mundshëm të ngjarjes. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se këto pretendime të kërkuesve janë haptazi të pabazuara.

43. Kërkuesit kanë pretenduar edhe cenimin e *parimit të sigurisë juridike dhe parimit të barazisë përpara ligjit*, pasi në kushtet kur Gjykata e Lartë ka praktikë të konsoliduar për pavlefshmërinë absolute të vendimeve gjyqësore dhe faktin që ajo mund të konstatohet kryesisht në çdo fazë të procesit, edhe kur pala nuk mund ta kërkojë atë, Kolegji Penal në këtë rast ka vepruar ndryshe.

44. Gjykata ka pohuar se zbatimi në mënyrë uniforme i ligjit, garantimin e të cilit, në instancë të fundit, Kushtetuta në nenin 141 ia ka ngarkuar në mënyrë të shprehur Gjykatës së Lartë, është një element thelbësor i parimit të barazisë përpara ligjit. Ky i fundit së bashku me parimin e sigurisë juridike ndërlidhen midis tyre, me qëllim garantimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Kjo do të thotë se individët kanë pritshmëri të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe mund të referohen në vendime gjyqësore të mëparshme për raste të ngjashme, në

mënyrë që të parashikojnë efektet juridike të veprimeve ose të mosveprimeve të tyre (*shih vendimin nr. 47, datë 11.06.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Po kështu, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se, kur kërkuesit pretendojnë cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit në lidhje me mënyrën sesi gjykatat kanë vendosur në raste të ngjashme, atëherë vlerësimi kushtetues i mënyrës së zgjidhjes së çështjeve të ngjashme nga gjykatat e zakonshme bëhet duke verifikuar rrethanat e rastit konkret. Fakti që gjykatat e zakonshme kanë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, në vetvete nuk mund të justifikojë *apriori* pretendimet e individit, pasi mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykatë, për sa kohë çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, harmonizuar edhe me rrethana, faktorë, motive ose prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë të njëjta (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 17, datë 23.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

46. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, Kolegji konstaton se kërkuesit në ankimin kushtetues individual janë mjaftuar duke përmendur praktikën e Gjykatës së Lartë, por pa dhënë detaje, si dhe duke mos arritur të provojnë se nga vendimet e gjykatave të zakonshme janë cenuar të drejta të fituara, ndërkohë që faktet e pretenduara janë të pamjaftueshme për të krijuar pritshmëri të ligjshme. Në këtë optikë, Kolegji vlerëson se argumentet e kërkuesve janë të pamjaftueshme në nivel kushtetues për të vënë në diskutim parimet e barazisë përpara ligjit dhe të sigurisë juridike, ndaj këto pretendime nuk mund të merren në shqyrtim.

47. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, në lidhje me provat e fajësisë, vlerësohet se ai është i ndërlidhur me njërin nga argumentet e dhëna nga kërkuesit në kuadër të pretendimit për cenimin e prezumimit të pafajësisë, ndaj këto pretendime do të trajtohen së bashku. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se në vijim do të analizojë pretendimet e kërkuesve në këndvështrim të së drejtës për mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, të garantuar nga neni 32, pika 2, i Kushtetutës, si dhe të parimit të prezumimit të pafajësisë të ndërlidhur me të drejtën e aksesit dhe standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me të drejtën e aksesit dhe standardin e arsyetimit të vendimit

48. Kërkuesit kanë pretenduar se nga gjykatat e zakonshme nuk u arrit të provohet kryerja e veprës penale nga ata për anën objektive të saj. Për sa i takon anës subjektive, ku kërkohet dashja direkte, nga dëshmitë e punonjësve të policisë nuk ka rezultuar asgjë me interes për autorët, duke mos arritur t'i specifikojnë ata. Gjykata e shkallës së parë ka konkluduar se fajësia është vërtetuar mbi dëshmitë e tre personave, të cilët më pas i kanë ndryshuar ato dhe

se në gjykim ka pasur vetëm indicie dhe dëshmi kontradiktore. Gjithashtu, ajo gjykatë nuk ka arritur të argumentojë edhe faktin se përse vrasja e punonjësve të policisë ka mbetur në tentativë, ndërkohë që qëllohej me breshëri në ajër dhe jo drejt makinave të policisë. Po kështu, fajësia e kërkuesve është mbështetur kryesisht në deklaratimet e të bashkëpandehurve pa u konfirmuar me prova të tjera në kundërshtim me KPP-në. Edhe gjykata e apelit, në të njëjtën linjë si ajo e shkallës së parë, përmend dëshmitë dhe provat në mënyrë të përgjithshme, por pa analizuar se cilat prova konkrete mbështesnin dyshimet për fajësinë e kërkuesve. Gjykata e Lartë ka vijuar të njëjtën qasje si gjykatat e faktit, duke mos u dhënë përgjigje pretendimeve kushtetuese të ngritura në rekurs, si, papërdorshmëria e provave të marra nën ushtrimin e dhunës në kundërshtim me nenin 25 të Kushtetutës, si dhe duke konfunduar kompetencat e saj në shqyrtimin paraprak në dhomën e këshillimit me ato të seancës gjyqësore. Vendimi i Gjykatës së Lartë është plotësisht i paarsyetuar.

49. Kërkuesit, po kështu, kanë pretenduar se gjykatat kanë vlerësuar provat në mënyrë të njëanshme, duke marrë në konsideratë dhe duke i dënuar ata mbi prova të marra nën ushtrimin e dhunës, për rrjedhojë të papërdorshme. Mënyra sesi gjykatat i kanë analizuar provat, ka rezultuar me zhvendosje të barrës së provës nga prokurori te kërkuesit.

50. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Ndërsa neni 142, pika 1, i saj, parashikon se vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara.

51. Gjykata ka theksuar se, në rastin e gjykimit penal, parimi i prezumimit të pafajësisë është një nga elementet përbërëse të procesit të rregullt ligjor. Ai kërkon që deklarimi i fajësisë të të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes. Asnjë masë që barazohet me dënimin nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 27, datë 29.04.2025; nr. 20, datë 03.04.2024; nr. 4, datë 21.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet. Barra e provës i takon palës akuzuese dhe çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit. Gjykatat duhet ta mbështesin vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza. Ato janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime ose dyshime (*shih vendimet nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 10, datë 12.04.2022; nr. 12, datë 24.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

52. Gjykata gjithashtu ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën

për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për çështjen, pasi aksesimi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (shih vendimet nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese).

53. Lidhur me arsyetimin e vendimeve gjyqësore, Gjykata ka pohuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese). Po sipas Gjykatës, arsyetimi i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjit të Gjykatës së Lartë, gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (shih vendimet nr. 28, datë 01.11.2022; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese).

54. Gjithashtu, Gjykata ka theksuar se vlerësimi i provave është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, për qëllime të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të shqyrtojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese (shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese). Kur vlerësimi i provave nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm ka cenuar parimet, standardet ose të drejtat kushtetuese, atëherë çështja i nënshtrohet kontrollit kushtetues (shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 19, datë 04.04.2023; nr. 19, datë 07.07.2022 të Gjykatës Kushtetuese). Po kështu, Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Thënë ndryshe, Gjykata vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (shih vendimin nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese).

55. Nën dritën e standardeve kushtetuese të mësipërme, si dhe duke mbajtur në konsideratë pretendimet e kërkuësve, do të verifikohet nëse në procesin penal të zhvilluar ndaj tyre gjykatat e zakonshme kanë respektuar garancitë procedurale të parimit të prezumimit të pafajësisë. Po kështu, Gjykata do të verifikojë nëse gjykatat e zakonshme u kanë garantuar

kërkuesve aksesin, duke u dhënë përgjigje të arsyetuara pretendimeve të tyre konform standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe nëse ky arsyetim ka qenë ose jo arbitrar.

56. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda në vendimin e saj ka arsyetuar se nga aktet e çështjes ka rezultuar e provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se kërkuesit kishin kryer veprat penale për të cilat akuzoheshin. Sipas asaj gjykate, fajësia e tyre provohet nga deklaratimet e bëra në fazën e hetimeve paraprake nga E.K., Xh.M. dhe K.S. dhe E.B., si dhe nga provat e tjera shkencore të mbledhura në vendin e ngjarjes dhe nga përgjimi ambiental i të pandehurit Xh.M. e babait të tij. Të gjitha provat e administruara në seancë gjyqësore të çmuara në unitet me njëra-tjetrën provojnë tej çdo dyshimi të arsyeshëm se vrasja është kryer nga kërkuesit, sepse ka rezultuar e provuar që të dy të pandehurit kanë qëlluar drejtpërdrejt me armë zjarri ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit, duke vrarë njërin prej tyre dhe duke tentuar që të vrasin edhe pesë të tjerë dhe, për këtë shkak, duhet të përgjigjen penalisht për veprimet e paligjshme të kryera prej tyre.

57. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, nga ana e saj, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me arsyetimin se i gjen të bazuara përfundimet e arritura nga shkalla e parë. Ajo gjykatë arsyeton se gjatë shqyrtimit gjyqësor në shkallë të parë janë marrë në shqyrtim provat e kërkuara nga palët, të cilat i janë nënshtruar debatit gjyqësor. Po kështu, ajo gjykatë arsyeton se provat shkresore të pasqyruara në vendimin e gjykatës së shkallës së parë vërtetojnë në mënyrë të plotë dhe bindëse rrethanat e ngjarjes, kohën kur ka ndodhur ngjarja, vendin, mekanizmin e ngjarjes, si dhe pasojat e ardhura prej saj. Ajo gjykatë thekson se duhet pranuar fakti që, disa nga provat shkresore të shqyrtuara nuk japin të dhëna të drejtpërdrejta për veprimet ose mosveprimet konkrete të secilit të pandehur, por në raport me provat e tjera të këtij procesi kanë shërbyer për të konkluduar për ekzistencën e fajësisë ose jo të secilit të pandehur, si dhe rolit që ka pasur çdokush prej tyre në kryerjen e veprës penale. Në përfundim, ajo gjykatë arrin në të njëjtin konkluzion dhe ka të njëjtën çmuarje të provave, rrjedhojë e vlerësimit të tyre, me atë të shkallës së parë, si dhe, meqenëse nuk vëren asnjë boshllëk në arsyetim, me qëllim plotësimin e vendimit të shkallës së parë, ka vlerësuar të lërë në fuqi vendimin e kundërshtuar. Ajo gjykatë gjithashtu u ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të kërkuesve ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

58. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë rezulton se ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda lidhur me rekursin e paraqitura nga kërkuesit. Kolegji Penal ka arsyetuar se nga gjykimi i çështjes, referuar vendimeve të gjykatave të faktit, akteve të dosjes, në verifikim të shkaqeve të ngritura në rekurs, nuk gjenden shkaqe që ta bëjnë të cenueshëm vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, e cila ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Gjykata e Apelit për Krime të

Rënda, referuar edhe shkaqeve të parashtruara nga kërkuesit në rekurset respektive, ka respektuar standardin e arsytimit të vendimeve, duke u dhënë përgjigje pretendimeve të të gjykuarve në përputhje me ligjin. Ai kolegji vlerëson se vendimmarrja e Gjykatës së apelit, për sa i përket cilësimit juridik të faktit penal të atribuar të gjykuarve, analizës së faktit dhe provave ku bazohet fajësia e të gjykuarve, janë përputhje me përcaktimet e nenit 152 të KPP-së, për rrjedhojë vendimi i rekursuar nuk është i cenushtëm.

59. Bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese dhe referuar në tërësi përmbajtjes së vendimeve gjyqësore objekt kërkese, Kolegji evidenton se të dyja gjykatat e faktit e kanë bazuar kryesisht vendimmarrjen e tyre mbi disa dëshmi të të bashkëpandehurve të ndërthurura edhe me prova të tjera shkencore. Ndërkohë që Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, nga ana e tij, e ka konsideruar të drejtë këtë konkluzion të gjykatave të faktit.

60. Mbi këto fakte, Kolegji vëren se gjykatat e zakonshme, përfshirë Gjykatën e Lartë kanë përmbushur detyrimin e tyre kushtetues për respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë në vlerësimin e provave. Ato nuk kanë zhvendosur barrën e provës te kërkuesit dhe nuk kanë nxjerrë prezumime fakti të paarsyeshme. Gjykatat e faktit kanë arritur në përfundimin se ata ishin autorë të veprave penale, duke analizuar për këtë qëllim në vendimet e tyre përmbajtjen e provave të shqyrtuara dhe duke shpjeguar sesi ato lidheshin me njëra-tjetrën, pa i dhënë ndonjëherë prej tyre vlerë të paracaktuar. Ato kanë përcaktuar fajësinë e kërkuesve përtej dyshimeve të arsyeshme, bazuar në një mori provash, përmbajtja e të cilave është analizuar dhe arsyetuar mjaftueshëm. Gjithashtu, të tria gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar mjaftueshëm duke u dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të kërkuesve, duke përmbushur në këtë mënyrë standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, si dhe arsytimi i tyre nuk duket të jetë arbitrar. Ndërkohë, nuk rezulton që nga ana e gjykatave të zakonshme të jenë vlerësuar provat në mënyrë të njëanshme ose duke zhvendosur barrën e provës te kërkuesit. Kolegji Penal ka shqyrtuar rekursin në dhomën e këshillimit, duke vepruar në përputhje me kompetencat e tij dhe me rregullat procedurale që gjejnë zbatim gjatë shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë.

61. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuesve për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me të drejtën e aksesit dhe standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, është i haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme

62. Kërkuesit kanë pretenduar cenimin e së drejtës për të mos u deklaruar fajtorë mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, pasi, *së pari*, nga ana e gjykatave janë pranuar deklaratimet e E.K., Xh.M. dhe K.S., si dhe të vet kërkuesit Elvis Boci të marra nën

ushtrimin e dhunës dhe të torturës nga Policia e Shtetit dhe organi procedues në kundërshtim edhe me nenin 25 të Kushtetutës, çka i bën këto prova të papërdorshme. Gjykatat nuk i kanë verifikuar këto pretendime gjatë gjykimit, të cilat kanë qenë serioze, të besueshme dhe të mundshme për verifikim. *Së dyti*, në rastin e dëshmisë së K.S., njohja me fotografi e kërkuesve është bërë në kundërshtim me procedurën e kërkuar nga nenet 171 e vijues të KPP-së.

63. Sipas nenit 32, pika 2, të Kushtetutës, askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Marrja e provave në mënyrë të ligjshme përbën një aspekt të rëndësishëm të respektimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Në këtë drejtim, detyra e Gjykatës është të vlerësojë nëse procesi si i tërë, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, ka qenë i drejtë. Për të përcaktuar nëse procesi ka qenë i rregullt, duhet kontrolluar nëse e drejta e mbrojtjes është respektuar dhe duhet verifikuar në veçanti nëse kërkuesit i është dhënë mundësia për të vënë në dyshim autenticitetin e provave dhe kundërshtuar përdorimin e tyre (*shih vendimin nr. 57, datë 21.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

64. Po kështu, në jurisprudencën kushtetuese është evidentuar dallimi që ekziston midis mënyrës së marrjes së provave dhe vlerësimit të tyre në procesin gjyqësor. Vlerësimi, dobia dhe rëndësia e tyre provuese në një çështje konkrete janë, si rregull, detyrë e gjykatave të sistemit gjyqësor, ndërsa verifikimi i ligjshmërisë së krijimit dhe marrjes së provave i nënshtrohet edhe kontrollit të kësaj Gjykate, pasi ky aspekt i gjykimit ka lidhje të drejtpërdrejtë me procesin e rregullt ligjor. Gjykata mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për mënyrën e marrjes së provave, por jo të vlerësimit të tyre. Është vetë gjykata e zakonshme që vlerëson nëse provat duhet të merren dhe mënyra e vlerësimit dhe konkluzionet për to janë gjithashtu në kompetencë të saj (*shih vendimet nr. 19, datë 01.04.2021; nr. 21, datë 20.03.2017; nr. 19, datë 19.07.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

65. Kolegji vëren se llojet e provave dhe mënyrat e marrjes së tyre rregullohen posaçërisht nga ligji procedural penal. Neni 149 i KPP-së përcakton kuptimin e provës dhe parashikon se provat janë njoftimet për faktet e rrethanat që lidhen me veprën penale, që merren prej burimeve të parashikuara në ligjin procedural penal, në përputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë së tij. Për sa i përket objektit të provave, ai parashikohet nga neni 150 i KPP-së, sipas të cilit janë objekt prove faktet që kanë lidhje me akuzën, fajësinë e të pandehurit, caktimin e masave të sigurimit, dënimin dhe përgjegjësinë civile, si dhe faktet nga të cilat varet zbatimi i normave procedurale. Ndërkohë, neni 151 i KPP-së ka rregulluar konceptin e marrjes së provave, duke parashikuar se gjatë hetimeve paraprake provat merren nga organi që procedon, sipas rregullave të caktuara në këtë

kod (pika 1), kurse në gjykim ato merren me kërkesën e palëve dhe gjykata vendos me urdhër, duke përjashtuar provat e ndaluara nga ligji dhe ato që janë haptazi të panevojshme (pika 2), ndërkohë që provat e marra në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji nuk mund të përdoren, ndërsa papërdorshmëria ngrihet edhe kryesisht në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit (pika 4).

66. Mbi bazën e standardeve kushtetuese të mësipërme, përkundër pretendimeve të kërkuësve, referuar atij konteksti faktik dhe ligjor që evidentohet në rastin konkret, Kolegji do të analizojë nëse provat e pretenduara nga kërkuësit janë mbledhur në mënyrë të paligjshme dhe nëse ato janë përdorur për deklarimin e tyre fajtorë.

67. Lidhur me pretendimin e parë të kërkuësve që lidhet me pranimin e deklaratave të E.K., Xh.M. dhe K.S., si të marra nën ushtrimin e dhunës, nga ana e gjykatës së shkallës së parë është argumentuar se dëshmitë e dhëna në seancë gjyqësore nga shtetasit Sh.B., E.B. dhe M.B., por edhe nga shtetasit E.B. dhe A.B., dëshmi të cilat sipas mbrojtjes provojnë që deklaratimet e dhëna nga të bashkëpandehurit Xh.M., E.K. dhe K.S. janë dhënë nën presion dhe dhunë fizike e psikike, nuk janë vlerësuar si provë nga gjykata. Ajo gjykatë nuk i ka pranuar ato me arsyetimin se janë të njëanshme dhe të pabesueshme për faktin se dëshmitarët nuk kanë qenë të pranishëm në momentin kur janë marrë në pyetje të bashkëpandehurit dhe për këtë arsye nuk kanë pasur mundësi që të dinë për ndonjë rrethanë të pyetjes së tyre. Ndërsa për sa i përket marrjes në pyetje të të bashkëpandehurve të mitur, ajo procedurë është bërë në prani të prokurorit, të mbrojtësve të tyre, si dhe të psikologes, e cila ka dëshmuar edhe në seancë gjyqësore që ndaj personave të mitur nuk është ushtruar asnjë dhunë fizike ose psikike.

68. Këto pretendime janë marrë në shqyrtim edhe nga ana e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, e cila i ka konsideruar përfundimet e gjykatës së shkallës së parë si të drejta, duke i vlerësuar provat (dëshmitë) si të marra konform ligjit procedural penal, fakt ky i konfirmuar edhe nga dëshmia e dhënë në seancë nga ana e psikologes L.M., e cila ka asistuar në marrjen në pyetje të të pandehurve të mitur. Këto konstatime të gjykatave të faktit janë lënë në fuqi edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili ka arsyetuar se referuar shkaqeve të ngritura nga mbrojtja e kërkuësve për pavlefshmërinë e deklaratimeve, me të drejtë është revokuar vendimi i zhvillimit të gjykimit të shkurtuar, duke u dhënë përgjigje pas një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm faktit se pretendimet e të gjykuarve ishin tërësisht të pabazuara.

69. Referuar për sa më sipër, Kolegji vëren se nga ana e gjykatave të zakonshme është marrë në analizë pretendimi i kërkuësve për ushtrimin e dhunës, duke proceduar me gjykim të zakonshëm në mënyrë që mbrojtja e tyre të kishte mundësi të vërtetonte këto pretendime. Në këtë kontekst, Kolegji evidenton se nga ana e gjykatave janë analizuar rrethanat, si, marrja e deklaratës në prani të mbrojtësit dhe të prokurorëve, si dhe është pyetur në cilësinë e

dëshmitares psikologia që kishte asistuar gjatë marrjes në pyetje. Gjithashtu, në mënyrë të argumentuar nuk janë pranuar dëshmitë e të afërmeve të kërkuesve si të njëanshme. Po kështu, nuk rezulton që nga ana e kërkuesve të jetë paraqitur kallëzim penal për faktin e pretenduar ose të jetë mbajtur ndonjë raport mjeko-ligjor ku të evidentohet kjo dhunë. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se gjykatat e zakonshme kanë hetuar mjaftueshëm për këtë pretendim, për më tepër në kushtet kur gjykimi është zhvilluar me gjykim të zakonshëm, ndërkohë që as kërkuesit nuk kanë arritur të provojnë këtë pretendim të tyre, ndaj ky argument i tyre është haptazi i pabazuar.

70. Lidhur me pretendimin e dytë, se në rastin e dëshmisë së K.S. njohja me fotografi e kërkuesve është bërë në kundërshtim me procedurën e kërkuar nga nenet 171 e vijues të KPP-së, Kolegji vëren se, nga aktet bashkëlidhur ankimit, ky shtetas nuk ka bërë paraqitje për njohje referuar neneve 171 e vijues të KPP-së, por ka dhënë dëshmi si i bashkëpandehur, duke evidentuar gjatë marrjes në pyetje se i njihte kërkuesit dhe se ata kanë qenë pjesë e grupit që do të kundërshtonte me dhunë forcat e Policisë së Shtetit. Në këtë kontekst, edhe ky argument i kërkuesve nuk qëndron.

71. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuesve për marrjen e provave në kundërshtim me nenin 32, pika 2, të Kushtetutës, janë haptazi të pabazuara.

72. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.